



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
TRAJTIMI I STUDENTËVE SH.A. ELBASAN

Nr. 5856 Prot.

Elbasan, më 2 . 10 .2020

STATUTI I SHOQËRISË AKSIONARE  
TRAJTIMI I STUDENTËVE SH.A.ELBASAN

KREU I

EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

1. Shoqëria emërtohet **“TRAJTIMI I STUDENTËVE” SH.A.** Emërtimi i shoqërisë ka në nisje të fjalëve shkronja të mëdha. Në dokumentat, faturat, reklamat dhe botimet e nxjerra nga shoqëria, emri i saj do të ndiqet nga inicialet sh.a., dhe selia e saj e regjistruar (Elbasan), duke u shfaqur me emërtimin e plotë: **TRAJTIMI I STUDENTËVE SH.A. ELBASAN**
2. Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” sh.a., Elbasan është person juridik, i organizuar në formën e **shoqërisë tregtare aksionare**, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i azhornuar dhe ligji nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
3. Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” sh.a, Elbasan është shoqëri tregtare aksionare me kapital shtetëror.
4. Aksionar i vetëm (pronar) i shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a., Elbasan është personi juridik publik, **Bashkia Elbasan**, në cilësinë e njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore, që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kushtetutës së RSH dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

## **NENI 2**

### **OBJEKTI**

Objekti i shoqërisë është:

- a) Furnizimi dhe trajtimi i studentëve me ushqim, fjetje dhe shërbime të tjera hotelerie.
- b) Furnizimi dhe trajtimi i personave të ftuar apo vizitorë, delegacione apo personalitete të huaj apo Shqiptar, me ushqim, fjetje dhe shërbime të tjera hotelerie, sipas nevojave të Bashkisë Elbasan.

## **NENI 3**

### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të Asamblesë së përgjithshme të aksionereve.

## **NENI 4**

### **SELIA**

1. Selia e shoqërisë është në: Elbasan, Lagjia "11 Nëntori", Rruga "28 Nëntori", Konvikti i studentëve.
2. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është adresa elektronike e administratorit të shoqërisë.
3. Shoqëria mund të hapë edhe zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje të parashikuar nga ligji në shoqëri të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

## **KREU II**

### **KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET**

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 337.000.000 lekë. Kapitali i shoqërisë zotërohet në masën 100% nga aksionari i vetëm, Bashkia Elbasan. Numri i aksioneve është 337.000 aksione, me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë secili. Në kapitalin themeltar është përfshirë vlera e truallit, ku ngrihen godinat e Konvikteve.
2. Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet nëshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionereve (aksionari i vetëm) e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve (aksionari i vetëm), e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

## NENI 6

### AKSIONET

1. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.
3. Aksionet e kapitalit e të drejtat e lindura prej tyre munda t'i kalojnë të tretëve vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (aksionarit të vetëm).
4. Aksionet zotërohen në masën 100% nga aksionari i vetëm, Bashkia Elbasan.

## KREU III

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI ORGANET VENDIMARRËSE

## NENI 7

### ORGANET VENDIMARRËSE

1. Organet vendimarrëse të Shoqërisë "Trajtimi i Studentëve sh.a" Elbasan, janë:
  - a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve (aksionari i vetëm).
  - b) Këshilli mbikqyrës
2. Shoqëria "Trajtimi i Studentëve sh.a" Elbasan është shoqëri tregtare aksionare, e organizuar në sistemin me dy nivele, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet 2 organeve *Këshillit Mbikëqyrës* dhe *Administratorit*. Administratori drejton shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.

3.

## NENI 8

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE (MBLEDHJA E AKSIONARIT TË VETËM)

1. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve ushtrohen nga Aksionari i vetëm, Bashkia Elbasan.
2. Çështjet e lidhura me veprimtarinë dhe funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet mbledhjes së Aksionarit të Vetëm.
3. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve (aksionari i vetëm) përfaqësohet nga **Kryetari i Bashkisë Elbasan**. Vendimarrja në emër të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

- (aksionarit të vetëm) realizohet me përfaqësim nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare dhe ligji për vetëqeverisjen vendore. Akti i përfaqësimit miratohet nga Këshilli i Bashkisë Elbasan, për gjithë periudhën e mandatit të Këshillit të Bashkisë Elbasan.
4. Asambleja e Përgjithshme (aksionari i vetëm) mblidhet në selinë e shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së aksionarit të vetëm, rendi i ditës dhe organizimi i mbledhjes bëhet sipas mënyrës ë përcaktuar në ligj.
  5. Të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme (aksionarit të vetëm) duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
  6. Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë (aksionari i vetëm) merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
    - a) përcaktimin e politikave tregtare;
    - b) ndryshime të statutit;
    - c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikqyrës;
    - d) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
    - e) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
    - f) miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratorit, ekspertëve dhe likuiduesve.
    - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
    - h) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
    - i) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
    - j) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
    - k) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
    - l) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
    - m) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
    - n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
    - o) miraton lidhjen e marrëveshjeve tregtare që konsiderohen të rëndësisë së veçantë për funksionimin e shoqërisë, që janë: (i) marrëveshjet ku shoqëria është palë me vlerë mbi 50.000.0000 lekë; (ii) marrëveshjet e huave, apo kredive që merr shoqëria; (iii) marrëveshjet për donacionet/grantet që merr shoqëria.
    - p) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji, apo nga ky Statut.
  7. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
  8. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
    - a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
    - b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
    - c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
    - ç) vendimet për investime;
    - d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

**NENI 9**

**KËSHILLI MBIKQYRËS**

1. Këshilli Mbikqyrës vepron në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë.
3. Anëtarët Këshilli Mbikqyrës emërohen dhe shkarkohen dhe nga mbledhja e Aksionarit të vetëm.
4. Anëtarët e Këshilli Mbikqyrës janë persona fizik.
5. Kohëzgjatja e funksionit të anëtarëve të Këshilli Mbikqyrës është 3 vjet. Anëtarët e këshillit janë të rizgjedhshëm.
6. Skema e shpërblimit të Këshillit Mbikqyrës miratohet nga Asambleja e Përgjithshme. Anëtarët e Këshilli Mbikqyrës shpërblehen në bazë të Udhëzimit nr.318, date 08.04.2009, "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit Mbikqyrës në shoqëritë anonime shtetërore", me te gjitha ndryshimet.

**NENI 10**

**KRYETARI I KËSHILLIT MBIKQYRËS DHE ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE**

1. Këshilli Mbikqyrës zgjedh midis anëtarëve të tij Kryetarin, i cili thërret mbledhjen e këshilli mbikqyrës dhe drejton diskutimet. Kryetari zgjidhet për të gjithë kohën e mandatit të tij dhe është i rizgjedhshëm.
2. Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë mblidhet sa herë e kërkon interesi i shoqërisë me thirrjen e Kryetarit. Thirrja e mbledhjes dhe rendi i ditës i njoftohet anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës jo më pak se 5 (pesë) ditë kalendrike përpara zhvillimit të mbledhjes. Në rastet e emergjencës dhe nevojës së jashtëzakonshme, që vlerësoet nga Kryetari, thirrja e mbledhjes dhe rendi i ditës i njoftohet anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës 1 (një) ditë përpara zhvillimit të mbledhjes.
3. Këshilli Mbikqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet nga anëtarët e këshillit pas çdo mbledhjeje.
4. Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.
5. Këshilli Mbikqyrës mund të miratojë Rregullore më të detajuara për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës për këto rregullore merren në mënyrë unanime.
6. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm jo më pak se 2 (dy) anëtarëve.

7. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.
8. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, sipas përcaktimeve të Statutit apo të rregulloreve të Këshillit, mund të shprehin votën e tyre edhe me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, të cilat lënë gjurmë të identifikueshme, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i Këshillit Mbikqyrës ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje

## NENI 11

### MARRJA E VENDIMEVE TË KËSHILLIT MBIKQYRËS

1. Këshilli Mbikqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga Administratori i Shoqërisë dhe i jep këtij të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga administratori pa autorizimin e Këshillit Mbikqyrës.
2. Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
  - a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
  - b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
  - c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
  - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
  - e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
  - f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit mbikqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
  - g) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit t'i përcillet asamblesë së përgjithshme, si dhe t'i vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorit;
  - h) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit dhe t'ia përcjellë për miratim Asamblesë së Përgjithshme (Aksionarit të vetëm);

## **Statuti i Shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Elbasan**

- i) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
  - j) të miratojë Strukturën e organizimit të shoqërisë dhe Rregulloren e Përgjithshme të funksionimit të shoqërisë.
3. Administratori i Shoqërisë i paraqet këshillit mbikqyrës të paktën një here në tre muaj raport mbi aktivitetin e shoqërisë.
  4. Këshilli Mbikqyrës i propozon Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (Aksionarit të Vetëm) ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.
  5. Këshilli Mbikqyrës kryen çdo veprim tjetër të parashikuar nga dispozitat e ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me të gjitha ndryshimet.

### **NENI 12**

#### **ADMINISTRIMI**

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve (Aksionari i Vetëm) emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë.
2. Shoqëria administrohet nga Administratori i shoqërisë.
3. Administratori zgjidhet për një afat 3 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje, mbi baza kontratash të rinovueshme. Emërimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratori zgjidhet me kombësi shqiptare, nuk mund të ushtrojë veprimtarinë në më shumë se një shoqëri dhe nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç. Administratori mund të zgjidhet nga të punësuarit e rangut të lartë të shoqërisë, por edhe jashtë saj.
5. Administratori ka të drejtë, që brënda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të shoqërisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.
6. Shpërblimi i Administratorit përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, në aktin e emërimit.
7. Në rast vdekje, dorëheqje apo shkarkimi të parakohshëm të Administratorit, pasardhësi që zë vendin e tij zgjidhet menjëherë nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.
8. Mbas pranimit të emërimit të tyre, Administratori pranon me shkrim që marrëdhënia e tij me shoqërinë është e lidhur me bazë besimi dhe në lidhje me këtë, vendimi për t'i pushuar nga puna ata me anë të një vendimi, gjykohet si arsye legjitime dhe nuk mund të kundërshtohet në asnjë formë.

## NENI 13

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori i përmbahet me profesionalizëm të gjithë kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara në dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me te gjitha ndryshimet.
2. Administratori (ndër të tjera) ka të drejtë dhe detyrohet:
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqet Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t’u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
  - e) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
  - f) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
  - g) të raportojë përpara Këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
  - h) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë jo më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit dhe t’ia përcjellë për miratim Asamblesë së Përgjithshme (Aksionarit të vetëm);
3. Administratori i propozon Këshillit Mbikqyrës për:
  - a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të shoqërisë (Plan Biznesi).
  - b) Treguesit e performances që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si elementet bazë të vlerësimit të punës së shoqërisë.
  - c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - d) Hapjen e veprimtarive ose njësive të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë.
  - e) Shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërive sipas legjislacionit në fuqi.
  - f) Krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera.
  - g) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
  - h) Strukturën e organizimit të shoqërisë dhe Rregulloren e Përgjithshme të funksionimit të shoqërisë.



## Statuti i Shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Elbasan

- i) Fillimin e një çështje gjyqësore ose zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është përfshirë shoqëria, sa i përket konflikteve ligjore të krijuara gjatë administrimit të shoqërisë ose kur një veprim i tillë dëmton dukshëm të drejtat e shoqërisë.
4. Administratori propozon draft-vendime për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e Këshillit Mbikqyrës ose e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
  5. Detyrat, që i cakton ligji këshillit mbikqyrës, nuk mund t'u delegohen administratorëve.
  6. Administratori i Përgjithshëm ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.
  7. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nëshkruara nga Administratori i Shoqërisë dhe që nuk e tejkalojnë objektin e veprimitarisë së shoqërisë.
  8. Kompetencat e Administratorit që pëfaqëson shoqërinë do të përfshijnë, për këtë qëllim, kompetencën që të nëshkruaj çeqe, urdhëra, kontrata, nota zyrtare, drafte dhe dokumenta e instrumenta të tjerë në lidhje me aktivitetin e shoqërisë dhe të ekzekutojë çdo dokument që mban vulën e shoqërisë me përjashtim kur ekzekutimi i këtij dokumenti kërkohet ose lejohet të bëhet ndryshe nga ligji ose me përjashtim kur ekzekutimi i tij do t'i delegohet qëllimisht me vendim të Këshillit Mbikqyrës një zyrtari tjetër të shoqërisë.
  9. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nëshkruhen nga Administratori i shoqërisë ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.
  10. Administratori i shoqërisë harton strukturën e shoqërisë, të cilën e miraton në Këshillin Mbikqyrës.

### NENI 14

#### **RREGULLORET E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SHOQËRISË**

1. Shoqëria miraton Rregulloren e Përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të shoqërisë, e cila duhet të jetë në përputhje me strukturën e shoqërisë.
2. Rregullorja e Përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të shoqërisë hartohet nga Administratori i Shoqërisë dhe miratohet nga Këshilli Mbikqyrës.
3. Marrëdhëniet brenda shoqërisë, për sektorë apo aktivitete të veçanta, mund të detajohen edhe me rregullore të veçanta, të cilat miratohen nga Administratori i Shoqërisë dhe që duhet të jenë në përputhje me parashikimet e Rregullores së Përgjithshme.

### NENI 15

#### **DETYRIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA**

1. Përveç sa parashikohet në nenet 14, 15, 16, 17 e 18 të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" për detyrimin e besnikërisë, shmangien e konfliktit të interesit dhe ndalimit të konkurrencës, administratori dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës duhet:

- a) të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis;
  - b) të ushtrojnë kompetencat, që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - e) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve, sipas pikës 3 të nenit 13 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
  - f) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori dhe anëtarët e këshillit mbikqyres përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.
  3. Administratori apo anëtarët e këshillit mbikqyres, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t’i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t’i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
  4. Administratori apo anëtarët e këshillit mbikqyres kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer bashkarisht nga administratori dhe 1 apo disa anëtarë të këshillit mbikqyres, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

## **KREU IV**

### **VITI FINANCIAR, EKSPERTËT, PËRCAKTIMI I FITIMIT**

#### **NENI 16**

##### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

#### **NENI 17**

##### **LLOGARITË FINANCIARE DHE EKSPERTËT**

1. Administratori do të mbajë llogari adekuate dhe do të përgatisë raporte financiare për të reflektuar me kujdes kushtet financiare të shoqërisë në përputhje me standartet e kontabilitetit sipas parashikimit që bën ligji.
2. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve (Aksionari i vetëm) emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të jashtëm, të cilët do të kenë këto përgjegjësi:

## **Statuti i Shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Elbasan**

- Kontrollon të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë të mbajtur gjatë vitit financiar, apo dhe atë të mbajtur gjatë periudhave të veçanta në rastet e kontrolleve periodike të ushtruara prej ekspertit, kur ai është ngarkuar me një detyrë të tillë nga ana e Aksionerit të vetëm.
- Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme të Aksionereve për ta shqyrtuar e miratuar.
- Informon me shkrim Asamblenë e Përgjithshme të Aksionereve, Administratorin dhe Këshillin Mbikqyrës mbi çdo parregullsi ose mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve ose llogarive financiare të shoqërisë, që mund të rezultojnë në humbje materiale për shoqërinë, apo që mund të çenojnë të drejtat dhe interesat e të tretëve.
- Të rishikojë përshtatshmërinë e auditimeve dhe praktikave e procedurave të brendshme të kontrollit dhe nëse është me vend të bëjë rekomandime për përmirësimin e tyre.
- Të kryejë të gjithë detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me të gjitha ndryshimet

### **NENI 18**

#### **REZULTATI I USHTRIMIT DHE PËRCAKTIMI I FITIMIT**

1. Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve.
2. Nga fitimet e ushtrimit, pasi të jenë zbritur, kur është rasti, humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5 (pesë)% për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme. Kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar nuk bëhen më heqje nga fitimet e ushtrimit. Ajo (heqja) rifillon për një arsye të çfarëdoshme kur rezerva e domosdoshme ka zbritur në 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.
3. Përdorimi i fitimit bëhet me vendim të Këshillit Mbikqyrës.

### **KREU V**

#### **PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 19**

#### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

1. Prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë me vendim Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (aksionarit të vetëm) ose me vendim të gjykatës, për shkaqet e parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sipas ndryshimeve

- që do të pësojë në kohë, apo në aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi dhe që mund të parashikojnë shkaqe të prishjes së shoqërisë.
2. Administratorët janë të detyruar të regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata regjistron vendimin e prishjes ex officio.
  3. Procedurat e likuidimit të shoqërisë rregullohen nga kuadri ligjor në fuqi.

## NENI 20

### RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

1. Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.
2. Shoqëria mund të riorganizohet sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionereve (Aksionarit të vetëm), në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sipas ndryshimeve që do të pësojë në kohë.

## KREU VI TË NDRYSHME

### NENI 21 BAZA LIGJORE

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me të gjithë dispozitat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë Status, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me te gjitha ndryshimet, si dhe çfarëdo akti ligjor apo nënligjor në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, që sjell efekte në veprimtarinë e shoqërisë.
3. Ky Statut hyn në fuqi në momentin e miratimit dhe nëshkrimit të tij nga Aksionari i vetëm.

**MIRATOI**  
BASHKIA ELBASAN

**KRYETARI**  
Gledian LLATJA

